



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.241/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Dragashit, Nedžmidin Sejdilar, me adresë në Rr. Brodit, nr.167, Dragash, parashtruar kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.241/2025, e datës 17.10.2025, e parashtruar nga kandidatit i pavarur për kryetar të Komunës së Dragashit, Nedžmidin Sejdilar, e parashtruar kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 17.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Dragashit, Nedžmidin Sejdilar, të dorëzuar përmes postës me datë 14.10.2025, me të cilën pretendon se në vendvotimin 0503/04 në fshatin Restelicë, komuna e Dragashit tek vendvotimi përgjatë gjithë procesit të votimit ka qëndruar libri me listën e kandidatëve, ka qenë i rrethuar subjekti politik Jedinstvena Goranska Partija, Danis Hodža, duke i sugjeruar votuesit se si të votojnë, po ashtu në këtë libër është i rrethuar edhe emri i kandidatit nr.2 të LDK-së – Resul Fetahu. Po ashtu, nëpër rrjete sociale janë shpërndarë komente lidhur me shitblerjen e votave pranë shkollës së fshatit Restelicë nga përkrahës të kandidatit të LDK-Bexhet Xheladini. Provë: Fotografi të listës së votuesve (librit në vendvotim) dhe postimet në profilin e Nesim Hodza – pronari i mediumit Radio Bamubs.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 18.10.2025, ka deklaruar se KQZ, pas pranimi të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Dragashit, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim:

"KKZ, nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pa kënaqësive eventuale as në ditën e zgjedhjeve, as pas ditës së zgjedhjeve as në procesin e fillimit të numërimit të votave për Kryetar të komunave dhe subjekteve politike dhe se për këtë KKZ gjatë kësaj periudhe nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese. Ky proces është vëzhguar nga vëzhguesit e partive politike, po ashtu edhe nga vëzhguesit, ku nuk kemi pas as vërejtje më të vogël nga ana e tyre, sepse procesi ka qenë i rregullt dhe transparent. Po u bashkëngjisë edhe librin e votimit të VV 0503/04 ku thekson se ne ora 17:40 pasi ne njëherë nga kabinat tek lista e kandidateve kemi vërejtur disa shënime, i kemi marrë masat e parapara. Edhe në këtë vendvotim ekzistojnë kamerat." KKZ në

përgjigjen e tij, ka bashkangjitur dokumentet si: Librin e votimit të vendvotimit 0503/04, dhe formularët për votim me asistencë.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, është dorëzuar nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, gjeti se :

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Dragashit, Nedžmidin Sejdilar, janë të pa qëndrueshme, dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesë. Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesi i ankesës nuk ka mbështetur pretendimet e tij me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar dëshmi të karta, dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur parregullsitë e përmendura në ankesë apo se në rrjete sociale janë shpërndarë komente lidhur me shitëblerjen e votave pranë shkollës së fshatit Restelicë nga përkrahës të kandidatit të LDK- Bexhet Xheladini.

Po ashtu edhe nga provat, e bashkangjitura në përgjigjen e KQZ-së, konstatohet se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë të parashtruesit të ankesës sepse nuk është pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale nga vëzhguesit e partive politike dhe vëzhguesit ndërkombëtar as në ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe as Formularët e rezultateve të subjekteve politike (FRS), dhe Formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK) të ofruara në përgjigje nuk vërehet asnjë shënim apo vërejtje në Librin e Shënime në QKN, në Komunën e Dragashit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRËSIA

ZL.Anr.241/2025 më datë 20.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.